



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA ĐAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 19.06.2023

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 (paragrafi 63.1.1) të Rregullores për Prokurim Publik /Nr.001/2022, të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të 16.06.2023, të parashtruar nga Grupi Operatorëve Ekonomik Marisa SH.P.K. & NSHT"Viktory Com" Pjetër Qerimi B.I, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndërtimi-asfaltimi i rrugëve në fshatrat Pjetërshan, Kusar, Dol", Nr. i prokurimit- 632-23-4754-5-2-1, Nr. i brendshëm-632-23-058 -521, nxjerr:

V E N D I M

1. **Refuzohet** si e pabazuar Kërkesa për ri-shqyrtim e Grupit të Operatorëve Ekonomik Marisa SH.P.K. & NSHT"Viktory Com" Pjetër Qerimi B.I, e dt.16.06.2023, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndërtimi-asfaltimi i rrugëve në fshatrat Pjetërshan, Kusar, Dol", Nr. i prokurimit- 632-23-4754-5-2-1, Nr. i brendshëm-632-23-058 -521, kundër NJOFTIMIT MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, të datës 13.06.2023, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.

2. **Vërtetohet** NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, i publikuar me datë: 13.06.2023;

3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të anulohet aktivitetin e prokurimit;

4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe të publikohet në platformën elektronike të KRPP.

A r s y e t i m

Me dt.16.06.2023, Grupi Operatorëve Ekonomik Marisa SH.P.K. & NSHT"Viktory Com" Pjetër Qerimi B.I, ka parashtruar Kërkesë për rishqyrtim lidhur me aktivitetin prokurimit: "Ndërtimi-asfaltimi i rrugëve në fshatrat Pjetërshan, Kusar, Dol", Nr. i prokurimit- 632-23-4754-5-2-1, Nr. i brendshëm-632-23-058 -521.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 19.06.2023, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pretendimi juaj është i pabazuar, sepse anulimi i këtij aktiviteti të prokurimit ka ardhur si pasojë e asaj që njësia e kërkesës ka kërkuar nga Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, të verifikoj se këto rrugë a janë pronë publike apo private. Ka rezultuar që disa prej këtyre rrugëve/parcelave janë pronë private, dhe njësia e kërkesës ka kërkuar nga Zyra e Prokurimit që të mos bëj hapjen e këtij tenderi, mirëpo kur Zyra e Prokurimit i ka njoftuar se ky aktivitet është në fazën e vlerësimit, atëherë njësia e kërkesës ka kërkuar anulimi i tij.

E gjendur në këtë situatë Zyra e Prokurimit, ka vepruar konform nenit 43 paragrafi 43.5, pika i:

i. një shkelle e ligjit ka ndodhur ose do të ndodhë dhe nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një ndryshimi;

Më poshtë po ju përcjellim të dhënat nga Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë për këto rrugë/parcela :

ZK. Dujake

Dujakë - Rr. Shkolla – pc.nr. 957-0 (Pronar: Psh. Rruget Publike)

Zk. Hereq

Hereq - Aksi i Rr. Arben Qerimi – pc.nr. 763-0 (Pronar: Psh. Rruget Publike)

Rrugët "Luan Dinaj e Vehbi Hasanaj" dhe "Sadik Alijaj e Muhamet Zenuni", pc.nr. 352-1 (Pronar: Psh. Rruget Publike), pc.nr. 352-2 (Pronar: Familja Shabanaj), pc.nr. 364-0 (Pronar: Psh. Rruget Publike), pc.nr. 342-0 (Pronar: Kadri Thaqi)

Aksi i rr. GAZMEND RAMA – pc.nr. 760-0 (Pronar: Psh. Rruget Publike), pc.nr. 646-0 (Pronar: Psh. Rruget Publike)

Aksi i rr. 17 MARTIRET – pc.nr. 11-0 (Pronar: Psh. Rruget Publike), pc.nr. 762-0 (Pronar: Psh. Rruget Publike)

Aksi i rr. 1 UK SHABANI – pc.nr. 762-0 (Pronar: Psh. Rruget Publike),

Aksi i rr. Agim Meta – pc.nr. 408-0 (Pronar: Psh. Rruget Publike), pc.nr. 763-0 (Pronar: Psh. Rruget Publike), pc.nr. 198-0 (Pronar: Psh. Rruget Publike)

Rr.Kodra Dolit – pc.nr.243-0 (Pronar : familja Bardhoku),pc.nr.2087-0 (Pronar:PSH.Ujera publike),pc.nr.208-0(Pronar:PSH.rruge publike),pc.nr.2092-0(Pronar:PSH.rruge publike),pc.nr.181-0 ((Pronar:PSH.rruge publike)

Rr.Lorenc Antoni: Pc.nr.2091-0(Pronar:PSH.rruge publike),pc.nr.186-0 (Pronar:familja Nikolla)

Rr.Mark Paluca:pc.nr.2093-0(Pronar:PSH.rruge publike), pc.nr.71-0(Pronar:PSH.rruge publike), pc.nr.58-0(Pronar:PSH.rruge publike), pc.nr.699-0(Pronar:PSH.rruge publike), pc.nr.685-0(Pronar:familja Lazri), pc.nr.136-0(Pronar:PSH.rruge publike), pc.nr.139-2(Pronar:Zef Tahiri), pc.nr.678-8(Pronar:Martin Gjokaj), pc.nr.2115-0(Pronar:PSH.rruge publike), pc.nr.677-0(Pronar:Muse Orosi), pc.nr.676-0(Pronar:Muse Orosi), pc.nr.2087-0(Pronar:PSH.ujrat publike), pc.nr.2094-0(Pronar:PSH.rruge publike)

Rr.Don Bosko, Rr.Ideali : Pc.nr.258K-0(PSH.Rruget Publike)

Rr.Buna: Pc.nr.1013-3(PSH.Rruget Publike), Pc.nr.1013-5(PSH.Rruget Publike), Pc.nr.1288-1,2,3,4(Kristina Bezhi), Pc.nr.1013-6(PSH.Rruget Publike), Pc.nr.615-0(PSH.Rruget Publike), Pc.nr.1013-4(PSH.pasuri e fshatit)

Rr.Liza Vorfi: Pc.nr.480-0(familja Domgjoni), Pc.nr.481-0(PSH.Nikolle Domgjoni), Pc.nr.2096-0(PSH.Rruget Publike), Pc.nr.485-0(PSH.Rruget Publike).

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.

Faton Gutaj

Menaxher i Zyrës së Prokurimit



Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit te Komunës;
Te gjitha palëve te interesuara;
Arkivit të Komunës